



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2019:245710

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06586418

Rev.nr.540/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Mr.sc. Muhamet Rexha, anëtarë, në kontestin e paditësit M. F. nga S., rruga ..... nr....., kundër të paditurës Republika e Serbisë – Qeveria e R.S, Rr “...” nr.... Beograd, në çështjen juridike, të kompensimit të dëmi, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1720/2020, datë 15.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 11.12.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet se i pabazuar revizioni i paditësit M. F. nga S., rruga .... nr..., i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1720/2020, datë 15.09.2020.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1720/2020, datë 15.09.2020, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, dhe është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, C.nr.17/2019, datë 20.01.2020, me të cilin kjo gjykatë shpallet jo kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike për kompensimin e dëmit dhe ka hedhur poshtë padinë e paditësit.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që

revizionoi të miratohet si i bazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar të prishet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e shqyrtimit të revizionit në kuptim të nenit 215, lidhur me nenin 230 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega në Skenderaj, C.nr.17/2019, datë 20.01.2020, për shkak të mungesës së kompetencës së gjykatave vendore , është hedhur poshtë padia e paditësit kundër të paditurës Republika e Serbisë, për kompensimin e dëmit të shkaktuar gjatë luftës së vitit 1998-99. Në procedurën ankimore, ky aktvendim i gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1720/2020, datë 15.09.2020, kundër të cilit pala paditëse ka paraqitur revizion.

Në një gjendje të tillë të çështjes , Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi, se gjykatat e instancës me të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, me të cilën është paraparë që *“ Kur gjykata gjatë procedurës konstaton se për zgjedhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet in kompetente, do t'i shpallë të pa vlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur. Mirëpo gjykata nuk do të veproj ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet “*. Kështu, gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se çështja e parashtruar me padi nuk bie në kompetencë të ndonjë gjykate të vendit, andaj gjykata e shkallës së parë është shpallur jo kompetente dhe është hedhur poshtë padia e paditësit. Kjo sipas mendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për faktin se në rastin konkret, vijnë në shprehje normat e kolizionit të ligjit, sipas të cilave themelohet kompetenca e ndonjë gjykate të ndonjë vendi tjetër, dhe në bazë të dispozitës së nenit 28.2 të LPK-së, kur është fjala për kontestet me element të huaj, gjykata e vendit është kompetente vetëm nëse kjo kompetencë ndërkombëtare rrjedh shprehimisht nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose nga vet Ligji.

Me Ligjin e zbatueshëm në Republikës e Kosovës, përkatësisht *nenin 37.1 dhe nenin 38 të LPK-së, është paraparë kompetenca e përgjithshme territoriale e gjykatës ku gjendet vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi i të paditurit- kur ai është person fizik. Ndërsa, me nenin 39.1 të LPK-së, është paraparë se “për gjykimin në kontestet kundër Kosovës, njësisë vetëqeverisëse lokale si dhe formave tjera të organizimit territorial, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e kuvendit të saj “*. Kurse, në paragrafin 2 të këtij

*neni është paraparë se “ për gjykimin në kontestet kundër personave juridik të tjerë, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar.*

*Kështu, edhe në dispozitën e nenit 54 .1 të Ligjit mbi zgjidhjen e kolizionit të Ligjit me dispozitat e shteteve tjera parashihet se, në kontestet juridiko- pasurore kompetenca e gjykatës së vendit ekziston në qoftë se në vendin tonë ndodhet pasuria e të paditurit apo sendi që kërkohet me padi.*

Duke pasur parasysh dispozitën e lartpërmendur dhe ato që u theksuan më lartë, si dhe faktin se me padi është paditur Republika e Serbisë- Qeveria R.S. në Beograd, për kompensimin e dëmit (pra, në rastin konkret fjala është për kontest juridiko – pasuror në shtetin e huaj), vlejnjë normat e së drejtës ndërkombëtare), për të cilin kontest gjykata e vendit nuk është kompetente për të vendosur, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39 par. 1 e 2 të LPK-së, me rastin kur janë shpallë inkompetente për të gjykuar këtë çështje juridike dhe kanë hedhë poshtë padinë e paditësit, nga se, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë, ashtu që, për të vendosur për këtë çështje juridike nuk është kompetente Gjykata e Republikës së Kosovës për faktin se selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë si palë e paditur nuk ndodhet në territorin e Gjykatave të Republikës së Kosovës.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se në rastin konkret gjejnjë zbatim dispozitat e neneve 28,47,51,60,61 të LPK-së. Kështu, dispozita e nenit 28 të LPK-së, në të cilën thirret paditësi, e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar ( të huaj), nuk mund të zbatohet në rastin konkret, nga se, këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizik të huaj, e as me persona juridik të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri në momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare ( bilaterale etj. ) për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve .

Po ashtu në rastin konkret nuk qëndron as pretendimi i revizionit të paditësit se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompetencën territoriale të zgjedhur sipas nenit 47 dhe nenit 51 të LPK, si dhe kompetencën ndihmëse nga neni 61 të LPK-së, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, këto dispozita nuk kanë të bëjnë me rastin konkret juridiko – civil, dhe se në këtë kontest gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë aplikuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, duke marrë parasysh edhe arsyet tjera që u sipër theksuan.

Numri i lëndës: 2019:245710

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06586418

Për arsyet e paraqitura më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 lidhur me nenin 230 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.540/2024, datë 11.12.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami